



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Nr. 609/16 Prot.

Tiranë, më 18/7/2014

REKOMANDIM

Nr. 65, datë 18/7/2014

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit Prefektura Korçë.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr. 59 datë 11/04/2014 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është kryer kontrolli administrativ pranë kontrolluesit Prefektura Korçë me objekt: "Zbatimi nga ana e kontrolluesit Prefektura Korçë e ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar si dhe akteve të miratuara nga komisionerit, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij në fushën e mbikëqyrjes, kontrollit dhe bashkërendimit të veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor".

Prefektura Korçë, në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, është kontrollues publik, përfaqësues i Këshillit të Ministrave në Njësinë Administrativo-Territoriale të përcaktuar me ligjin nr. 8653, datë 31.07.2000 "Për ndarjen administrative territoriale të Njësisë së Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë", i cili funksionon në veprimtarinë e tij mbështetur në ligjin "Për Prefektin" dhe në akte ligjore dhe nënligjore të Këshillit të Ministrave.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë suaj ju mblidhni, përpunoni dhe ruani të dhëna personale të qytetareve dhe të punonjësve kryesisht në rrugë manuale, si dhe nëpërmjet sistemeve e programeve elektronike. Përpunimi i të dhënave personale dhe informacionit pranë kontrolluesit bëhet vetëm në rrugë manuale nëpërmjet krijimit të dosjeve, trajtimit ruajtjes arkivimit të tyre.

Rezulton se njohuritë e punonjësve tuaj lidhur me kërkesat e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" të ndryshuar dhe Autoritetin e Komisionerit, janë jo në nivelin që kërkon koha, prandaj është e nevojshme që nga ana juaj të ndërmerren aktivitete dhe nisma të ndryshme për informimin dhe sensibilizimin e punonjësve lidhur me rëndësinë që ka mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësisë.

Aktiviteti që u realizua nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Bashkinë Korçë i shërbeu sensibilizimit jo vetëm të punonjësve tuaj por edhe të kontrolluesve tjerë të rëndësishëm në qytetin e Korçës dhe në këtë rast ju shprehim

falënderimet tona për pjesëmarrjen në këtë aktivitet, ku u diskutua për respektimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Roli dhe puna e personit të ngarkuar (*ose oficeri i mbrojtjes të të dhënave personale*), i caktuar tashmë nga Institucioni juaj në zbatim të nenit 3/14 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, për sensibilizimin e punonjësve dhe publikut për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë, duhet të mbështetet fuqimisht nga organet drejtuese të Institucionit tuaj. Regjistrimi i personit të ngarkuar (*ose oficeri i mbrojtjes të të dhënave personale*) të Institucionit tuaj pranë KMDP, shton besimin dhe transparencën e procesit të përpunimit të të dhënave personale.

Është shumë e rëndësishme që nga Institucioni juaj të merren masa që në kontratat e lidhura me punonjësit, si dhe në kontratat e shërbimit në marrëdhëniet me të tretë të vendosen dispozita ku të përcaktohen detyrime për mbrojtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave personale. Nga ana juaj është plotësuar gabim formulari i njoftimit në rubrikat 3.1 "*kategoritë e subjekteve të të dhënave*" dhe 10.1 "*masat e sigurisë dhe politikat e ruajtjes së të dhënave personale*", duke mos zbatuar kështu kërkesat e nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar. Në njoftim duhet të deklaroni nëse përpunimi i të dhënave bëhet për një qëllim apo për disa qëllime, një përshkrim i përgjithshëm i masave për sigurinë e të dhënave personale, nëse janë hartuar, miratuar dhe zbatohen rregulla konkrete të cilat bëjnë të mundur përpunimin e sigurte dhe të ligjshëm të të dhënave personale.

Institucioni juaj mbikëqyr ambientin e jashtëm të godinës së Prefekturës nëpërmjet përdorimit të sistemit të "*video-survejimit*" dhe mbledh, përpunon, ruan të dhëna personale (*imazhe*). Vendosja e sistemit të "*video-survejimit*" në hyrje të godinës zyrtare për qëllime sigurie dhe për të mbikëqyrur hyrjet dhe daljet në ndërtesë duhet të respektojë të drejtën për informim të subjekteve që janë nën vëzhgimin e kamerave. Vendosja e tabelave bëhet në vende të dukshme, në këto tabela duhet të vendoset emri i kontrolluesit dhe një numër kontakti ku subjektet e të dhënave personale të drejtohen për të ushtruar të drejtën e tyre për tu ankuar në rast të keqpërdorimit të të dhënave të tyre personale.

Rezultoni se Institucioni juaj nuk ka përcaktuar rregulla të shkruara, për përdorimin e këtij sistemi dhe nuk ka vendosur tabela informuese për informimin e subjekteve të të dhënave për përdorimin e kamerave të "*video survejimit*". Përdorimi i sistemit të "*video survejimit*" duhet të respektojë të drejtat e liritë e subjekteve të të dhënave personale, të cilat janë të mbrojtura nga neni 8 i Konventës Evropiane për "*Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut*" si dhe ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

Hartimi i rregullave është një siguri më shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave, gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryeni ju si kontrollues. Nga ana juaj duhet të zbatohen kërkesat e parashikuara në ligjin nr. 9887 datë 10/03/2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, prandaj është e nevojshme të hartohen rregulla lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale, konfidencialitetin, sigurinë dhe ruajtjen e të dhënave personale.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative :

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të neneve 21e vazhdim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të plotësohen në formularin e njoftimit rubrikat 3.1 “kategoritë e subjekteve të të dhënave” dhe 10.1 “masat e sigurisë dhe politikat e ruajtjes së të dhënave personale”. Informacione të rëndësishme lidhur me njoftimin mund të gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë.

2. Në zbatim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 3 datë 05/03/2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera” i ndryshuar:

- në vende të dukshme të vendosen tabela informuese për publikun, lidhur me mbikëqyrjen e ambienteve me anë të sistemit të “video survejimit”.
- të hartohet rregullore lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, me anë të sistemit të “video survejimit”.

3. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të hartohet rregullore e brendshme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale. Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë.

4. Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të realizohet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij Rekomandimi.

5. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

6. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbashje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, sipas të cilit: “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

